



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 268, Datë 14.10.2022

MBI

RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 250, DATË 13.12.2022, MBI RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 112, DATË 26.04.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K., PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 34, DATË 04.02.2021, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SH.P.K., PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË VENDIMIT NR. 61, DATË 02.11.2007, I NDRYSHUAR”

DHE

RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 164, DATË 20.06.2022, MBI TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË SHOQËRISË “HERA”SH.P.K., NR. 49, SERIA NPM07P, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT NR. 61, DATË 02.11.2007, “PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË (PROJEKTI KAPPET)”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2 dhe 3 dhe nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799/8 prot., datë 12.10.2022 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbykëqyrjes, lidhur me kërkesën e shoqërisë “SOT-AL” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 250/2021,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 250, datë 13.12.2021, vendosi:
 1. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 3.1, 3.3 dhe pikën 4, gërma “a” dhe “b” (Leja e Mjedisit, dokumentacioni pronësor, miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacioni përkatës vërtetues për realizimin e investimeve), të Vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, nga shoqëria “HERA” sh.p.k.
 2. Shoqëria “HERA” sh.p.k. të informojë/dokumentojë në ERE çdo muaj ecurinë e plotësimit të këtyre kushteve.
 3. ERE ka të drejtë të rishikojë këtë vendim në çdo kohë në përputhje me informacionin/dokumentacionin e përditësuar sipas pikës 2 të këtij vendimi, apo aktet ligjore apo nënligjore të dala nga organet kompetente.

- ERE njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 250/2021 me shkresën nr. 961/13 prot., datë 28.12.2021 dhe me shkresën nr. 169 prot., datë 24.01.2022, ERE i kujtoi asaj detyrimin për të informuar/dokumentuar në ERE ecurinë e plotësimit të kushteve të këtij vendimi.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 164, datë 20.06.2022, ka vendosur transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k. me nr. 49 Seria NPM07P, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, me kapacitet të instaluar 150 MW, për një afat 30 vjeçar, te shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. Me këtë vendim janë transferuar dhe të drejtat dhe detyrimet që shoqëria “HERA” sh.p.k. ka në kuptim të kësaj licence dhe vendimit nr. 250, datë 13.12.2021
- Në vijim dhe në kuadër të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 250/2021, shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 65/6 prot., datë 18.03.2022, nr. 65/11 prot., datë 29.04.2022, 65/15 prot., datë 22.06.2022, 65/16 prot., datë 30.06.2022, nr. 1378, datë 25.07.2022, . 65/18 prot., datë 01.08.2022, nr. 65/19 prot., datë 04.08.2022, 65/20 prot., datë 09.09.2022, 65/22 prot., datë 12.09.2022, si dhe shkresën nr. 65/23 prot., datë 30.09.2022, është depozituar dhe dokumentacion, nga i cili rezulton si më poshtë.
- Përsa i përket pajisjes me *Lejen e Mjedisit*, shoqëria ka depozituar në ERE, Deklaratën mjedisore, të datës 09.09.2022, me nr. komisioni 59, lëshuar për personin juridik “HERA” sh.p.k., për të zhvilluar projektin “Ndërtimi, instalimi dhe shfrytëzimi i centralve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga këto centrale”, parku eolik KAPPET, për të zhvilluar këtë projekt në territoret e bashkive Pogradec, Maliq dhe Devoll të Qarkut Korçë, me kapacitet të instaluar 150 MW + 10%.
- **Sa më sipër rezulton se shoqëria aplikuese, “SOT-AL” sh.p.k. është pajisur me Deklaratën Mjedisore përkatëse, duke plotësuar në këtë mënyrë një nga kushtet e vendosura në pikën 1 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 250/2021.**
- Në lidhje me *miratimin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale*, shoqëria ka bërë me dije se pavarësisht se është për t’u riverifikuar, në Deklaratën Mjedisore është konstatuar se 26 pika të përzgjedhura lokalizohen në zonën buferike të rezervës të biosferës ndërkufitare së Ohrid-Presepë. Ky dokument kërkon që të rishqyrtohet pozicionimi i këtyre pikave, për t’i sjellë ato në territorin e zonës tranzitore të kësaj njësie, gjë që kërkon një rilevim thelbësor topografik, gjë që mund të ndryshojë edhe vendosjen e terreneve dhe përkatësinë e tyre juridike. Në këto rrethana, ajo ka pezulluar aktivitetin në terren të ekspertëve për sa kohë nuk është përcaktuar përfundimisht sipërfaqja e shtrirjes së projektit dhe lidhja e kontratave të qirasë me bashkitë respektive.
- **Sa më sipër, rezulton se shoqëria nuk e ka plotësuar ende këtë kusht, por ka argumentuar pezullimin e procedurës për t’u pajisur me këtë miratim, për shkak të nevojës për të përcaktuar fillimisht sipërfaqen e shtrirjes së të gjithë projektit.**

- Përsa i përket *dokumentacionit pronësor*, shoqëria ka njoftuar se, sikurse informuar më parë dhe nga shoqëria “HERA” sh.p.k. dhe specifikisht në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016, “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, procedura e rilidhjes së kontratave të qirasë së tokës me bashkitë respektive kërkon plotësimin e dokumentacionit me Deklaratën Mjedisore. Më tej shoqëria angazhohet që pas marrjes së transferimit të Deklaratës Mjedisore, do të procedojë me përgatitjen e dokumentacionit dhe aplikimin për qiramarrjen e terreneve.
- **Sa konstatuar në Udhëzimin nr. 1/2016, konkretisht pika 10, gërma “h”, përcakton se pjesë e dokumentacionit për të marrë në përdorim një sipërfaqe të caktuar nga fondi pyjor kullësor publik është dhe leja mjedisore. Sa më sipër, për të vijuar me plotësimin e këtij kushti, fillimisht duhet të bëhet transferimi i Deklaratës Mjedisore nga shoqëria “HERA” sh.p.k., te shoqëria “SOT-AL” sh.p.k.**
- Përsa i përket *realizimit të investimeve* për zhvillimin e projektit, shoqëria ka bërë me dije se ka investuar një vlerë neto investimesh kapitale dhe ekspertize, të cilat pasqyrojnë studimet dhe punimet e kryera për instalimin dhe mirëmbajtjen e anemometrave të matjes së shpejtësisë së erës, të kryera gjatë periudhës 2008-2022. Këto investime i ka pasqyruar në një tabelë përmbledhëse, të nënshkruar dhe vulosur nga shoqëria, ku përcaktohet se nuk janë përfshirë shpenzimet administrative dhe pagesa të ndryshme për efekt të detyrimeve ndaj palëve të treta.
- **Sa bërë me dije më sipër nga shoqëria, mbetet në kuadrin e deklaratës, pasi nuk është shoqëruar me dokumentacion ligjor vërtetues për realizimin e këtyre investimeve (si p.sh. fatura).**
- Në përfundim të sa deklaruar dhe depozituar, shoqëria ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 250/2021 me 12 muaj.
- Për gjithë sa më sipër, duke marrë në konsideratë përpjekjet e shoqërisë për të plotësuar kushtet e vendimit nr. 250/2021, raportimet periodike të saj, ku janë pasqyruar e dokumentuar vonesa që nuk varen nga vetë shoqëria dhe pajisjen me Deklaratën Mjedisore, vlerësohet të pranohet kërkesa e shoqërisë për shtyrjen e afatit të vendosur në pikën 1 të vendimit nr. 250/2021.
- Gjithashtu, në kuadër të vlerësimit të përpjekjeve të shoqërisë në plotësim të ktyre kushteve, vlerësohet që t’i lihet asaj detyrimi për të depozituar në ERE, një progres raport me informacione çdo 3 (tre) muaj.
- Gjithashtu, referuar faktit se në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 164, datë 20.06.2022, për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “HERA” sh.p.k. me nr. 49 Seria NPM07P, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar, te shoqëria “SOT-AL” sh.p.k., është përcaktuar detyrimi që deri në datën 13.09.2022 shoqëria “SOT -AL” sh.p.k. të dokumentojë edhe mbështetjen financiare që do të sigurojë për projektin KAPPET, vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet nga vendimi nr.

164/2022 dhe t'i lihet detyrimi shoqërisë që këtë kusht ta plotësojë se bashku me kushtet e tjera të vendimit nr. 250/2022, që mbeten ende pa plotësuar.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë kushtin e vendosur në pikën 1 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 250/2021, që ka të bëjë me depozitimin e Lejes Mjedisore.
2. Pika 1 e vendimit nr. 250, datë 13.12.2021 ndryshon si vijon:
 1. *Të zgjasë me 3 (tre) muaj afatin e depozitimit të miratimit nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe me 6 (gjashtë) muaj afatin e depozitimit në ERE të dokumentacionit pronësor, duke filluar ky afat nga data 14.09.2022.*
3. Pika 2 e vendimit nr. 250, datë 13.12.2021 ndryshon si vijon:
 2. *Shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. të depozitojë në ERE çdo 3 (tre) muaj një progres raport me informacion për investimet që do të kryejë, në kuadër të plotësimit të kushteve të sipërcituara.*
4. Shoqëria “SOT-AL” sh.p.k. të paraqesë në ERE në mënyrë periodike me data të rifreskuara dokumentet që i nënshktohen rinovimit të afateve.
5. Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 164, datë 20.06.2022, shfuqizohet.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe MIE-n për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI